



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**K.DH.Shk II.nr. 308/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbaremore të kreditorit “Premier Archive” L.L.C., me NUI:810848848, me seli në Magjistralen Prishtinë - Ferizaj, kundër debitorit “Komuna e Prishtinës”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit “Avokatura Istrefi” Sh.p.k., me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.1047/22 të datës 29.09.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Komuna e Prishtinës”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1047/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1047/22 të datës 29.09.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Komuna e Prishtinës”, me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 1243/21, i lejuar me datë 16.09.2021, nga Përmbareuesi Privat Isa Gacaferi dhe Urdhri Përmbaremore P.nr. 1243/21, i lejuar me datë 16.09.2021, nga Përmbareuesi Privat Isa Gacaferi mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1047/22 të datës 29.09.2023

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Premier Archive” L.L.C., ka paraqitur propozim për përmbartim P.nr. 1243/21, i lejuar me datë 16.19.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; – Fatura nr.0131-2-20 e datës 31.01.2021, nr.0228-2-20 e datës 28.02.2021, nr.0331-2-21 e datës 31.03.2021, nr.0430-1-21 e datës 30.04.2021, nr.0531-1-21 e datës 31.05.2021; ku e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 9,242.91 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e arrijtes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se faturat e bashkangjitura në propozim janë kopje dhe nuk i plotësojnë kushtet esenciale sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se propozimit nuk i është bashkangjitur as edhe një kontratë me të cilën tregohet raporti juridik i debitorit dhe kreditorit prandaj burimi i faturave është i panjohur. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, shfuqizohet urdhri përmbartimor si dhe të detyrohet kreditori që t’i mbuloj shpenzimet e përpilimit të prapësimin.

Po ashtu edhe kreditori në përgjigjen në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pa bazuara pasi që faturat i kanë të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë. Tutje ka shtuar se pretendimi që burimi i faturave është i panjohur nuk qëndron pasi që ekziston

marrëveshja për ruajtjen e dokumentacionit të debitorit e datës 06.06.2019. Në vazhdim ka deklaruar se debitori ka pranuar borxhin në korrespondencën me postë elektronike të datës 23.08.2021. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj në tërësi prapësimin si të pabazuar, mbetet në fuqi urdhri përmbartimor si dhe të obligohet debitori që t'i mbuloj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nga përmbartuesi privat, duke u bazuar në dokumente të besueshme – Fatura nr.0131-2-20 e datës 31.01.2021, nr.0228-2-20 e datës 28.02.2021, nr.0331- 2-21 e datës 31.03.2021, nr.0430-1-21 e datës 30.04.2021, nr.0531-1-21 e datës 31.05.2021; të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat/shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shumata e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Në rastin konkret rezulton se

faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar pranë organit kompetent noterit, të njëjtat janë pranuar nga debitorit në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kundërshtuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Poashtu, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se mbi cilën bazë ligjore kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit pasi që nuk janë bashkangjitur kontrata me të cilat tregohet raporti juridik i kreditorit me debitorin, erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitorit, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit duke konsideruar se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës

materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaremore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbaremore, respektivisht është lejuar përmbaremi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbareshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimit si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbareues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbaremore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbaremore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranimit të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbaremore organi përmbareues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbaremit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbareues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbareues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas propësimi i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaremore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K. DH.Shk II.nr. 308/24 me datë 16.04.2024**

**Gjyqtarja,**

**Saranda Bogaj Sheremeti**